

kthye në shtëpi, por nuk diti asgjë për fatin e të atit. Një ditë më vonë, vëllai i Musliut ka shkuar në Kroimirë/Krajmirovce për të ndriçuar fatin e Musliut. Disa banorë të fshatit i thanë se e kishin vërejtur Musliun më 17.07.1998, kur kishte ardhur për ta kërkuar të birin. Por, ata nuk dinin çfarë kishte ndodhur me vonë. Fati i Musliut nuk është i njohur as sot e kësaj dite. Në regjistrin e personave të zhdukur, të cilën e administron KNKK-ja, zhdukja e Musliut është evidentuar në lëndën me numër BLG-804814-01.

Burimet: deklarata S.M, FDH-36445; FDH, *Regjistri i kufomave...*, FDH-12986; FDH, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 123; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Tefik (Habib) Vuniqi

(13.03.1982, shqiptar nga Vërsheci/Vrševece, komuna e Lipjanit/Lipljan, nxënës)

Forcat serbe e sulmuan më 17.07.1998 fshatin Vërshhec/Vrševece nga drejtimi i bjeshkës së Goleshit/Goleš. Tefiku dhe familja e tij e morën vendimin për tu arratisur nga fshati. Përderisa familjarët e tij i bënin teshat gati, Tefiku u nis vetëm në pyll. Por, nuk arriti të strehohet atje sepse një predhë eksploidi shumë afër tij dhe e la të vdekur në vend. Në datën 18.07.1998, familjarët e kanë varrosur Tefikun në varrezat e Mëhallës Mziu në Vërshhec/Vrševece. Pas lufte, në muajin mars të vitit 2000, mbetjet mortore të Tefikut u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Vërshhec/Vrševece.

Burimi: deklarata H.V, FDH-11623.

Muharrem (Hamit) Çadraku

(19.06.1943, shqiptar nga Vërsheci/Vrševece, komuna e Lipjanit/Lipljan)

Muharremi jetonte në bashkësi familjare me të vëllain Haradinin me familje në fshatin **Vërshhec/Vrševece**. Haradini me familje e braktisën fshatin më 17.07.1998, ndërsa Muharremi ndenji në shtëpi. Ka qenë i sëmurë. Ishte kjo hera e fundit që i vëllai e shihte të gjallë. Një muaj më vonë, KNKK-ja e ka njoftuar Haradinin se trupi i të vëllait ishte zbuluar në Vërshhec/Vrševece dhe se

u bart në morgun e Prishtinës/Priština. Haradini e ka marr trupin e të vëllait dhe me ndihmën e familjarëve e kanë varrosur në fshatin Ribari i Madh/Veliki Ribar në muajin shtator të vitit 1998. Pas lufte, në muajin mars të vitit 2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Muharremit në varrezat e Vërshecit/Vrševece.

Burimi: deklarata E.Ç, FDH-11598.

Goran (Đorđe) Živić

(25.08.1969, serb nga Lipjani/Lipljan, recepcionist)

Gorani punonte si pjesëtar i shërbimit të sigurimit në *TE Obiliq/Obilić*. Jetonte në **Lipjan/Lipljan**, së bashku me dy vëllezër. Në datën 21.07.1998, ai ka shkuar në pazarin e zarzavateve dhe pasi i ka blerë ca artikuj dhe gjëra të tjera që i duheshin, shkoi në kafenenë e Novica Baždarevićit. Nga ky çast, atij i humbet çdo gjurmë. Motra e Goranit ka dëgjuar nga një grua e panjohur, e cila banonte afër ambulancës, se tre burra e kanë detyruar Goranin që të hynte në automobilin e tyre dhe se ai, më këtë rast, rezistonte. Në rrugë kanë mbetur të shpërndara sendet ushqimore dhe papuçet e tij të plastikes. Zhdukja e tij është regjistruar nga KNKK-ja në lëndën me numër YUK-050053-01.

Burimet: deklarata I.D, FDH-29572; deklarata N.N, FDH-5511; USCG KGDH, Regjistri..., FDH-8817; OMPE, *Slušajte...*, 104-116; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Ismail (Gani) Bërbatovci

(15.04.1959, shqiptar nga Dobraja e Madhe/Veliko Dobranje, komuna e Lipjanit/Lipljan, gazetar, dy fëmijë)

Ismaili ka qenë profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Punonte si redaktor i gazetës *Fjala Jonë*. I vizitonte shpesh shtabet lokale të UÇK-së, sikurse në datën 17.07.1998, kur shkoi në shtabin e UÇK-së në **Blinajë/Lipovica**. Një javë më vonë, më 23.07.1998, ai ka shkuar në bisedën e caktuar paraprakisht me anëtarin e shtabit kryesor të zonës operative, Ramë Buja. Dy ditë më vonë, familjarët e tij kanë mësuar nga një banor i Dobrajës së Madhe/Veliko